



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Dokumenti nr: 24.34.9-2015-08

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI IMPLEMENTIMIN E
KONTRATËS PËR SISTEMIN E PROKURIMIT
ELEKTRONIK**

Auditim i performancës

Prishtinë, Korrik 2016

Zyra Kombëtare e Auditimit , e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

Ky raport vlerëson Implementimin e Sistemit të E- prokurimit.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Implementimin e Kontratës për Sistemin e Prokurimit Elektronik” në konsultim me Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm Artan Venhari, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Myroete Gashi, mbështetur nga Ariana Gjonbalaj (Udhëheqës Ekipi) dhe Elvin Mala.

Lista e shkurtesave

ANZh	-	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
AQP	-	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ASHI	-	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	-	Banka Botërore
KDP	-	Komiteti Drejtues i Projektit
KIP	-	Komiteti për Implementim të Projektit
KKP	-	Komiteti Këshillimor i Projektit
KRPP	-	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	-	Ligji i Prokurimit Publik
MAP	-	Ministria e Administratës Publike
MF	-	Ministria e Financave
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
NjMP	-	Njësia e Menaxhimit të Projekteve
NVM	-	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OSHP	-	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RPO	-	Recovery Point Objective (Objektivi i pikës së rimëkëmbjes)
RTO	-	Recovery Time Objective (Objektivi i kohës së rimëkëmbjes)
SI	-	Sistemi Informacionit
ZKA	-	Zyra Kombëtare e Auditimit

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	1
1.1	Përkufizimi i sistemit të prokurimit elektronik.....	1
1.2	Detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë projekt	3
1.2.1	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)	3
1.2.2	Ministria e Financave.....	3
1.2.3	Banka Botërore.....	4
1.3	Përfitimet ekonomike dhe sociale.....	4
1.4	Metodologjia e Auditimit	7
2	Konkluzione dhe rekomandime	8
2.1	Konkluzionet kryesore.....	8
2.2	Konkluzionet sekondare	8
2.2.1	Organizimi institucional i zbatuar vetëm pjesërisht	10
2.2.2	Qeverisja joadekuate e Sistemeve të Informacionit	12
2.2.3	Siguri e pamjaftueshme për Sisteme të Informacionit	15
2.2.4	Ndërveprimi.....	17
2.2.5	Joefikasitet në transfer të njohurive	19
2.2.6	Sigurimi joadekuat i performancës së sistemit	20
	Terminologjia	22
	Referencat.....	24

1 Hyrje

Qëllimi i këtij auditimi ishte të vlerësohet implementimi i një sistemi të ri të TI-së për mbështetjen e proceseve të prokurimit të Qeverisë së Kosovës.

Pas një analize të plotë që kishte përfshirë palët më të rëndësishëm të interesit dhe konsulentë të jashtëm, në vitin 2012 nga Banka Botërore është aprovuar raporti 'Prokurimi elektronik dhe raporti i gatishmërisë'. Ky raport përmbante një plan udhëzues për futjen e një sistemi të TI-së për të menaxhuar të gjitha proceset e prokurimit të Qeverisë së Kosovës në të gjitha nivelet të entiteteve.

Plani udhëzues ka orientuar drejt hartimit të një plani për zhvillimin e sistemit të 'e-prokurimit' për Kosovën mbështetur nga Banka Botërore. Kontrata e detajuar e cila kishte përfshirë kërkesat e e-prokurimit është nënshkruar më 08 dhjetor 2014 për një vlerë të përgjithshme prej 578,991€ në mes Bankës Botërore dhe Ministrisë së Financave, kontratë kjo e nënshkruar në emër të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) me konsorciumin e përbërë nga një kompani kroate (Infodom) dhe një kompani kosovare (Komtel). Implementimi i projektit kishte filluar më 15 dhjetor 2014 dhe fillimisht është pritur të përfundojë brenda një viti (14 dhjetor 2015).

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës e konsideron këtë sistem mjaft të rëndësishëm për Qeverinë e Kosovës, për palët e shumtë të interesit përfshirë entitetet publike dhe ekonomike, do të përmirësojë proceset, shtojë efikasitet dhe do të rrisë transparencën. Për më tepër, Projektet e TI-së të kësaj natyre janë konsideruar me rrezik të lartë për shkak të kompleksitetit, palët e shumtë të përfshirë dhe ndërveprimin me sistemet e tjera të TI-së së Qeverisë që duhet shoqëruar për shkëmbimin efektiv të të dhënave.

1.1 Përkufizimi i sistemit të prokurimit elektronik

Plani udhëzues vënë në pah një mësim të rëndësishëm nga të gjitha zhvillimet kombëtare që e-prokurimi nuk është thjesht një aplikacion softuerik, dhe qasja në të si i tillë nuk do të rezultojë në një përfundim të suksesshëm. E-prokurimi është program strategjik dhe është jetike që të ekzistojë një dizajn i mirë biznesor. Nuk mjaftojnë vetëm mjetet teknike për të siguruar sukses. Thënë shkurt, prokurimi elektronik nuk është vetëm një zgjidhje teknike, por një zgjidhje biznesore *fund-në-fund*.

Kontrata parasheh që sistemi i prokurimit elektronik të bazohet në një zgjidhje standarde softuerike të quajtur @Spin, e zhvilluar nga INFODOM që është implementuar edhe në disa vende të tjera. Softueri i personalizuar është dashur të shtoj funksionalitete të përshtatura për kontekstin e Kosovës.

Fushëveprimi i projektit përfshinë zhvillimin e moduleve kyçe për:

- Regjistrimin e centralizuar të operatorëve ekonomik, autoritetet kontraktuese, Agjencinë Qendrore të Prokurimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe përdoruesit tjerë;
- Paneli punues (Dashboard);
- Tenderimi elektronik (nga planifikimi i prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës);
- Marrëveshjet elektronike kornizë;
- Ankandet elektronike;
- Ankandet e kthyeshme elektronike;
- Moduli për Agjencinë Qendrore të Prokurimit;
- Moduli për Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Sistemi i menaxhimit të kontratës;
- Administrimi i Sistemit dhe Sigurisë;
- Përdorshmëria dhe Ndihmesa e Aplikacionit.

1.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë projekt

1.2.1 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) të Kosovës, KRPP:

- Është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe zbatimin e LPP-së;
- Është përgjegjës për monitorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e LPP-së në Kosovë;
- Sigurimin që sistemi i tillë vepron në mënyrë që të arrijë shfrytëzim sa më të lartë, racional, efikas dhe transparent të mjeteve publike, duke inkurajuar konkurrencën, dhe respektuar barazinë e pjesëmarrësve në procesin e prokurimit publik.

KRPP-ja përbëhet nga katër departamente, njëra nga te cilat është Departamenti i Teknologjisë Informative përgjegjës për zhvillim strategjik të sistemit të informacionit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe statistikat e mbledhura për prokurim. Në kuadër të këtij projekti:

- Testimi Operacional i Pranimit do të jetë përgjegjësi kryesore e KRPP-së (PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03, 2014).
- KRPP-ja do të jetë përgjegjëse për kujdesin dhe pronësinë e Sistemit apo nën-sistemit pas dorëzimit dhe të mirëmbajtjes në të ardhmen (PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03, 2014).

1.2.2 Ministria e Financave

Përgjegjësitë kryesore të Ministrisë së Financave janë si më poshtë:

- Bashkërendon zhvillimin dhe siguron realizimin e balancuar të buxhetit vjetor për administratën publike;
- Krijon buxhete shumëvjeçare dhe programe afatgjata për investime publike në bashkëpunim me institucionet e administratës publike;
- Bashkërendon me institucionet e administratës publike dhe, sipas nevojës, me donatorët multilateralë e bilateralë për çështjet që kanë të bëjnë me financimin nga donatorët dhe kontributet e dhuruara;
- Siguron përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve të donatorëve për qëllimet e akorduara;
- Kujdeset që të gjitha të ardhurat dhe burimet e tjera të financimit nga institucionet e administratës publike, duke përfshirë dhe ndihmat financiare vullnetare, të regjistrohen sipas rregullave buxhetore;
- Siguron zbatimin e legjislacionit tatimor dhe doganor në Republikën e Kosovës;

- Bashkërendon dhe koordinon aktivitetet e institucioneve ndërkombëtare financiare; etj.

1.2.3 Banka Botërore

Prokurimi elektronik është pjesë e Projektit për Modernizimin e Sektorit Publik të Bankës Botërore (PMSP) që ka këto objektiva kryesore:

- Forcimi i punës së organizatave kyçe buxhetore në formulimin e buxhetit, ekzekutimin e buxhetit dhe prokurimin publik;
- Krijimi i themeleve për menaxhim të qëndrueshëm fiskal të pagave dhe menaxhim efektiv të burimeve njerëzore në shërbimin kryesor civil;
- Krijimi i kushteve për automatizimin e mëtejshëm të proceseve të punës së qeverisë dhe për zhvillimin e aplikacioneve të e-qeverisjes.

Data e Aprovimit të këtij projekti ishte 04 Shkurt 2010 ndërsa data e mbylljes së projektit të PMSP-së është 30 qershori 2016 (World Bank PSMP, n.d.).

1.3 Përfitimet ekonomike dhe sociale


Pasi interneti që nga mesi i viteve 1990 ka ofruar mjete menaxheriale për furnizim, kompanitë janë përpjekur ti marrin përfitimet të cilat mund ti ofrojë e-prokurimi: reduktimin e kostos, riorganizimin e procesit, përputhshmërinë e përmirësuar të kontratës, shpenzimet e rritura nën menaxhim, dhe më shumë (Aberdeen Group).

Plani udhëzues përcakton qëllimet kryesore të Programit të e-Prokurimit, si në vijim:

- Rritjen e aftësive vendimmarrëse të zyrtarëve të prokurimit duke siguruar informacion kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës të prokurimit;
- Përmirësimin e planifikimit financiar dhe buxhetimin;
- Përmirësimin e transparencës në procedurat dhe praktikat e prokurimit;
- Efikasitet në të gjithë procesin e prokurimit dhe minimizimi i kohës së ciklit të prokurimit;
- Nxitjen dhe inkurajimin e pjesëmarrjes dhe promovimin e konkurrencës ndërmjet furnizuesve;
- Shfrytëzimin e ekonomisë së shkallës nëpërmjet grumbullimit të kërkesës dhe maksimizimi i vlerës për para në prokurimin qeveritar;
- Rritjen e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në procesin e prokurimit qeveritar dhe përdorimin e fondeve publike;

- Optimizimin e niveleve të inventarit përmes adoptimit të praktikave efikase të prokurimit;
- Sigurimin e konfidencialitetit, integritetit dhe vërtetësisë të të gjitha transaksioneve dhe të dhënave ndërmjet entiteteve të prokurimit dhe furnizuesve;
- Përmirësimin e niveleve të shërbimit për të gjitha palët e përfshira të interesit në prokurimin qeveritar.

Këto politika janë përmbledhur si tre objektiva të gjera të nivelit të lartë siç tregohet në figurën më poshtë.



Vlera ekonomike e prokurimeve të Qeverisë arrin rreth 390 milion euro (Raporti Vjetor i Prokurimit 2014, 2015). Përfitimet e mundshme të një sistemi efektiv dhe efikas të e-prokurimit tejkalojnë për shumë herë investimin për vetë sistemin dhe mund të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik si dhe klimën e investimeve.

Për më tepër, theksohet se sistemi i e-prokurimit do të jetë i detyrueshëm për të përmbushur direktivën e BE-së (2014/24/BE) në këtë fushë (DIRECTIVE 2014/24/EU, 2014).

1.4 Metodologjia e Auditimit

Qasja jonë e auditimit fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim efektiv të kontratës.

Gjatë këtij auditimi, ne kryesisht jemi fokusuar në pyetësorë, intervista, analiza, rishikim të dokumenteve dhe ekzaminime fizike. Ne kemi vlerësuar planin udhëzues, kontratën, menaxhimin e projekteve dhe raportet e progresit. Intervistat janë zhvilluar me palët relevante, siç janë: kryetari i bordit të KRPP-së, anëtarët e bordit, drejtori i departamentit për teknologjinë e informacionit dhe zyrtarët e departamentit për trajnim. Ne gjithashtu kemi zhvilluar intervista me palët tjera duke përfshirë edhe Ministrinë e Financave, Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit dhe Bankën Botërore.

Ne kemi zhvilluar një takim me palët e interesit të nivelit të lartë ku kemi diskutuar gjetjet tona paraprahe për të siguruar se janë marrë të gjitha informatat relevante për të ofruar saktësinë dhe objektivitetin e këtij raporti.

Për shkak të rëndësisë së këtij projekti, ne gjithashtu kemi kryer një vizitë studimore për të identifikuar praktikat më të mira të implementimit të e-prokurimit në një shtet anëtar të BE-së.

Fillimisht ne kishim si synim të vlerësonim ndërlidhjen (interface) me sistemet e tjera, testimin, trajnimin e përdoruesve, manualet e përdorimit, sigurinë logjike, dhe kontrollet e brendshme brenda sistemit, por për shkak të mos zhvillimit të këtyre pjesëve ne kemi kryer Auditim administrativ dhe të sistemeve të informacionit.

Ky auditim përfshinë vitin 2015, deri në shkurt të vitit 2016 kështu që të gjeturat e prezantuara në këtë raport ndërlidhen me atë periudhë.

Bashkëpunimi me KRPP-në gjatë kësaj kohe ka qenë i mirë dhe ata na kanë ofruar dokumentet e duhura sipas kërkesës.

2 Konkluzione dhe rekomandime

2.1 Konkluzionet kryesore

Një pjesë e madhe e sistemit të e-prokurimit ende nuk është implementuar plotësisht. Shumë prej rezultateve të projektit nuk janë realizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve menaxheriale, njerëzore dhe teknike në agjencitë përgjegjëse qeveritare. Për shkak se përfitimet e mundshme janë plotësuar vetëm pjesërisht, sistemet e vjetra manuale me jo eficiencën dhe rreziqet e ndërlidhura mbesin të njëjta. Potenciali i përfitimeve të softuerit të zhvilluar dhe harduerit të implementuar mbetet shumë i nën-shfrytëzuar dhe nuk është e sigurt se kjo do të përmirësohet në të ardhmen e afërt. Plani udhëzues i projektit dhe kontrata fillestare përmbanin një bazë të duhur për një projekt të suksesshëm, edhe pse kohëzgjatja e realizimit të projektit ishte e shkurtër. Do të duhen përpjekje të mëtejshme nga qeveria për të pasur përfitime të plota të e-prokurimit në të ardhmen e afërt. Megjithatë, në momentin që KRPP-ja do të ndërmerë përpjekje serioze për tu përmbajtur planit udhëzues, hartimi i një plani përcjellës për vitet e ardhshme do të mundësojë që të plotësohen mungesat në detyrimet e organizatës. Prandaj, ZKA ka dhënë një numër rekomandimesh që ndërlidhen me konkluzionet sekondare që duhet të jenë të zbatueshme.

2.2 Konkluzionet sekondare

Konkluzionet sekondare bazohen në konkluzionin tonë kryesor.

Organizimi institucional

1. Korniza e pritur e implementimit të projektit e cila parashihte krijimin e një numri të organeve këshilluese/rishikuese (Komitetin Drejtues të Projektit, Komitetin e Implementimit të Projektit, Njësinë e Menaxhimit të Projekteve dhe Komitetin Këshillues i Projektit) nuk është zbatuar në mungesë të dërgimit të informatave të organeve qeverisëse për ecurinë (statusin) e Projektit. Kjo edhe njëherë ka zvogëluar monitorimin efektiv dhe ndërhyrjen me kohë që më pas ka rezultuar në kosto dhe vonesa në zbatimin e projektit. Praktikrat e mira tregojnë se duhen vite për të implementuar prokurimin elektronik, përderisa KRPP -ja ka vlerësuar se kjo mund të implementohet brenda një viti¹.

Qeverisja e Sistemeve të Informacionit

2. Nuk ekziston ndonjë dokumentacion i cili demonstroi kornizë efektive qeverisëse që përfshin politikat dhe procedurat (miratimin ose zbatimin e tyre) ose planin e menaxhimit/veprimin të rrezikut që duhet të konsiderohet në mënyrë efektive për të trajtuar rrezikun.

¹ Praktikrat e mira të marra nga vizita studimore e ekipit në një shtet anëtar të BE-së.

Siguria e Sistemeve të informacionit

3. KRPP është dashur të sigurojë një mjedis të sigurtë për funksionimin e e-Prokurimit në mungesë të Infrastrukturës së çelësave publike (Public Key Infrastructure - KPI). Propozimi për të përdorur sistemin e-ID-së në pronësi dhe të zhvilluar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me nivele të mira të sigurisë kishte implikime logjistike/të kostos dhe KRPP-ja kishte vendosur të lë që përdoruesit të autentikohen (identifikohen) duke përdorur autentikim vetëm një faktorësh: emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Kjo rrit rrezikun e përdorimit të paautorizuar të sistemit.

Ndërveprimi

4. Sistemi i e-prokurimit pritet të shkëmbejë informacione me shërbimet tjera të e-qeverisë për të vërtetuar dhe proceduar të dhënat dhe të shmang dyfishimin në mënyrë efektive. Shumë pak është bërë në lidhje me këtë, edhe pse disa nga arsyet për këtë janë jashtë ndikimit të KRPP-së.

Transferimi i njohurive

5. Nuk është ndërmarrë trajnimi i pritur i 800 përdoruesve. Është mbajtur një trajnim shumë i kufizuar për Trajnim-të-Trajnerëve (ToT). Këtë vitë KRPP-ja është duke planifikuar të trajnojë 300 përdorues - normë e cila do të kërkonte tre vjet (3) për të trajnuar të gjithë përdoruesit dhe kështu do të vononte zbatimin e plotë të e-Prokurimit sipas rrjedhës aktuale të planeve kohore.

Sigurimit i performancës së sistemit

6. Ne nuk kemi qenë në gjendje të verifikojmë nëse janë bërë të gjitha testimet nga ana e Blerësit. Edhe pse Ofertuesi i ka ofruar librat e testimi/rastet, ato janë realizuar vetëm pjesërisht. Komunikimi dhe përgjigja ndaj kërkesave nga ana e Blerësit është bërë pjesërisht duke përdorur librat e testimi/rastet. Bazuar në këtë, është pothuajse e pamundur të gjurmohet dhe të verifikohet plotësimi i ndryshimeve.

Këto të gjetura sekondare janë shpalosur më në detaje në seksionet nga 2.2.1 deri më 2.2.6.

2.2.1 Organizimi institucional i zbatuar vetëm pjesërisht

Plani udhëzues i e-prokurimit i përgatitur në tetor të vitit 2012 (IGS-PPRC, 2012) ka theksuar metodologjinë e menaxhimit të projektit dhe kërkesat institucionale. Këto rekomandime janë bartur në Termat e Referencës të projektit dhe janë përfshirë në Kontratën e nënshkruar mes palëve përkatëse.

Kriteret:

Është rekomanduar të themelohen një numër i organeve për të rregulluar, ofruar mbikëqyrje dhe komunikuar për aktivitetet dhe rezultatet e projektit me disa prej qëllimeve si më poshtë:

- Komiteti Drejtues i Projektit (KDP) - KRPP ka themeluar KDP-në të përbërë nga përfaqësues ekzekutiv të palëve kryesore të interesit. Ky komitet duhet të punojë sipas objektivave të përcaktuara. Është e rëndësishme që të gjithë anëtarët e KDP-së të jenë plotësisht të vetëdijshëm për të gjitha aspektet e programit të e-Prokurimit përfshirë synimet dhe objektivat e saj.
- Komiteti për Implementimin e Projektit (KIP) - kërkohet të mbështetet nga një Komitet Këshillues dhe duhet të përfshijnë përdorues të e-prokurimit, si dhe specialistë të TI-së nga entitetet qeveritare. Këta individë duhet të mbeten, pavarësisht çfarëdo ristrukturimi të agjencive të origjinës, dhe duhet të raportojnë KDP-së.
- Njësia e Menaxhimit të Projektit (NjMP) - ka rol në dy faza, përkatësisht (i) gjatë zhvillimit dhe Implementimit të sistemit, dhe (ii) për mbështetje të vazhdueshme, kur e-Prokurimi bëhet operacional. NjMP duhet të udhëhiqet nga një Drejtor me orar të plotë, i cili është përgjegjës ndaj KRPP-së dhe i raporton KIP-së dhe, sipas nevojës edhe KDP-së. NjMP do të organizojë edhe grupe punuese/komitete ndër-sektoriale për të çuar përpara aspektet e ndryshme.
- Komiteti Këshillimor i Projektit (KKP) - duhet krijuar një grup këshillues i agjencive për të ndihmuar lidhur me çështjet e zhvillimit dhe implementimit si dhe për të ndërtuar bashkëpronësi.
- Rolet dhe përgjegjësitë e Sistemeve të Informacionit (SI) duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të aprovuara nga Menaxhmenti i lartë i institucionit. Duhet të përcaktohet nëse përshkrimi formal i punës dhe strukturat përkojnë me ato reale dhe nëse janë adekuate.

E gjetura:

- a) Korniza e pritur e implementimit të projektit e cila parashihte krijimin e një numri të organeve këshilluese/rishikuese (KDP, KIP, NjMP dhe KKP) nuk është zbatuar duke rezultuar në një mungesë të përcjelljes të informatave të organeve qeverisëse për ecurinë (statusin) e Projektit. Është themeluar ekipi i projektit, por pa përcaktim të qartë të funksionit dhe përgjegjësisë, për këtë arsye ka vepruar pjesërisht si NjMP dhe KIP.

- b) KRPP-ja për gati dy muaj, gjatë qershorit dhe korrikut, ishte pa Bord të Drejtorëve, dhe pas ri-themelimit, është emëruar vetëm një anëtar i Bordit për të mbikëqyrur implementimin e projektit, por jo organ siç rekomandohet. Kjo ka rezultuar në komunikim të dobët në mesin e palëve të interesit, çështjet e llogaridhënies dhe pronësisë nuk ishin qartë të përcaktuar, dhe si rezultat i kësaj situata nuk ka përparuar në raport me monitorimin efektiv dhe ndërhyrjen me kohë. Çështjet me të cilat janë përballur nuk u përshkallëzuan si duhet në një nivel më të lartë për t'u zgjidhur. Kjo rezultoi në kosto dhe vonesa në implementimin e projektit.
- c) Me zhvillim të projektit, nuk janë identifikuar kërkesat, shqyrtimet, testimet dhe zbatimi i duhur i ndryshimeve. Mund të ketë mangësi në konfigurim mes zgjidhjes fillestare të propozuar gjatë fazës së kontratës dhe produktit final të zhvilluar, pra duke rezultuar në menaxhim jo të duhur ose të pa-disponueshëm të sistemit pasi nuk ka dëshmi se është bërë modifikimi.
- d) Struktura e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në kuadër të KRPP-së nuk është miratuar zyrtarisht nga drejtuesit e lartë të organizatës, e as rolet dhe përgjegjësitë e tilla nuk janë përcaktuar qartë, as ndarja e detyrave nuk është bërë si duhet.
- e) Aktivitetet e tavolinës mbështetëse/ndihmëse duhet të përcaktohen qartë në mënyrë që të ndihmojnë përdoruesit të cilët përballen me çështje të ndryshme ose gabime që ndërlidhen me shërbimet e ofruara. Gjatë periudhës së garancisë (1 vit) ofertuesi do të duhej të sigurojë ueb portal (Komtel, 2015) që do të mundësojë regjistrimin dhe përcjelljen e çështjeve të raportuara, por është e paqartë se çfarë do të ndodhë me të dhënat pas skadimit të periudhës së garancisë. Funksionaliteti i tavolinës mbështetëse/ndihmëse nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe nuk është aprovuar nga menaxhmenti i lartë.

Rekomandojmë Ministrin e Ministrisë të Financave të sigurojë që:

- a) Edhe pse zhvillimi dhe zbatimi i projektit është në fazën përfundimtare, duhet të krijohen organet, për të siguruar menaxhim dhe mbikëqyrje efektive të fazës së implemetimit dhe pas implementimit të projektit.

Rekomandojmë Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

- b) Procedurat e menaxhimit të ndryshimit duhet të paraqiten dhe të zbatohen në bazë të një procesi të përcaktuar dhe dokumentuar për të identifikuar dhe për të aplikuar përmirësimet teknologjike të nivelit të infrastrukturës dhe të aplikacionit. Kjo do të kodifikojë pritjet e përdoruesve të departamentit të teknologjisë së informacionit (TI),si dhe pranimin e ndryshimeve. Duhet të ekzistoj një proces i qartë i përgatitjes, menaxhimit dhe fuqizimit të ndryshimeve, e që do të përfshijë miratimin e Menaxhmentit të lartë dhe angazhimin për ndryshime (përfshirë por jo të kufizuar edhe në harnime "patch" dhe përmirësime"update").
- c) Menaxhmenti i lartë duhet të miratojë skemën organizative dhe rolet dhe përgjegjësitë e departamentit të Teknologjisë së Informacionit në kuadër të KRPP-së. Përshkrimet e punës, Tabelat RACI dhe diagramet e matricës të rrjedhës së punës duhet t'u sigurojnë

punonjësve një drejtim më të plotë dhe të qartë sa i përket roleve dhe përgjegjësive të tyre”, përfshirë por jo kufizuar në funksionet e administrimit të sistemit, administrimit të sigurisë, tavolinës së shërbimit (tavolinës ndihmëse), menaxhimi i mediave, administrimi i bazës së të dhënave, dhe zhvillimin e aplikacionit dhe mirëmbajtjes. Ndarja e detyrave duhet të zbatohet, kontrollohet dhe përcaktohet duke zbatuar autorizimin e transaksionit, rruajtjen e aseteve, qasjen në të dhëna dhe format e autorizimit.

- d) Pronësia e Portalit dhe të dhënave të ndërlidhura duhet të merren përsipër nga KRPP-ja për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të parandaluar humbjen e të dhënave në lidhje me gabimet e raportuara nga përdoruesit.

Praktikat e mira

Në mënyrë që proceset dhe shërbimet që ofrohen nga organizata të funksionojnë me sukses dhe zhvillohen më tej, kapacitetet e stafit të TI-së duhet të pasurohen me njohuri mbi menaxhimin e projekteve të TI-së, Menaxhimin e shërbimeve të TI-së, sigurinë fizike dhe logjike, dhe fushat tjera të ndërlidhura të cilat sigurojnë zhvillimet në hap me teknologjinë dhe trendet e fundit.

2.2.2 Qeverisja joadekuate e Sistemeve të Informacionit

Sistemi i e-prokurimit, në bazë të kontratës duhet të jetë përgjegjësi e vetme e KRPP-së dhe ata do të jenë pronarët e sistemit. KRPP-ja do të marrë kodin burimor të sistemit dhe të gjitha informatat e nevojshme dhe qasjen në softuer, i cili do t’u mundësojë atyre të modifikojnë dhe përshtatin aplikacionin në të ardhmen nëse është e nevojshme.

Si pronare e sistemit, KRPP-ja gjithashtu do të jetë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, procedurave, apo ndonjë rregullore tjetër përkatëse.

Kriteret:

- a) Sipas “Politikës Menaxhuese, Legjislacionit dhe Modelit të Biznesit” të kontratës, politikat e mëposhtme në lidhje me transaksionet elektronike do të zhvillohen si pjesë e implementimit:
- Politika e Sigurisë së TI-së përfshirë ndërlidhjen me administratorin;
 - Politika e përdorimit të aplikacionit (përfshin edhe klauzolën për përgjegjësi të kufizuar);
 - Politika e gjurmëve të auditimit;
 - Planifikimi i vazhdimësisë së biznesit;
 - Planifikimi nga rimëkëmbja prej fatkeqësive;
 - Politika e kopjes rezervë (Backup);
 - Politika arkivore; dhe

- Politika e e-Pagesave/faturave;
- b) Politikat dhe rregullat e prokurimit në mjedisin e e-Prokurimit duhet të adresojnë edhe disa çështje menaxheriale:
- Mosperputhja në mes të dokumentacionit elektronik dhe atij fizik nga agjencitë qeveritare, dhe nga sektori privat;
 - Mosfunksionimi i strukturës qeveritare para kohës së mbylljes të caktuar për dërgimin e ofertës elektronike;
 - Procedurat e hapjes së ofertave elektronike në letër;
 - Angazhimi dhe lehtësimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve);
 - Aplikacionet e M-teknologjisë; dhe
 - Metoda e autentikimit;
- c) Sistemi do të sigurojë objektivin e pikës së rimëkëmbjes (RPO) prej 24 orësh dhe objektivin e kohës së rimëkëmbjes (RTO) prej 2 orësh, si minimum.
- d) Shërbimi i Garancisë dhe Pas-Garancisë: Përgjigje ndaj kërkesës nga blerësit ose përdoruesit për rregullimin e problemeve dhe kërkimi i ndihmës për të përdorur sistemin duhet të jetë e menjëhershme, jo më vonë se 12h; Ofertuesi do të sigurojë një (1) vit garanci për sistemin e prokurimit, tre (3) vjet garanci për kompjuter/server/laptop, dhe dy (2) vjet garanci për pajisje të tjera.

E gjetura:

- a) Nuk ekziston ndonjë dokumentacion i cili demonstroi kornizë efektive Qeverisëse që përfshin politikat dhe procedurat (miratimin ose zbatimin e tyre) ose planin e menaxhimit/veprimit të rrezikut që duhet të merret në mënyrë efektive për të trajtuar rrezikun.
- b) Janë disa udhëzime administrative (UA-01/2010, 2010) (UA-02/2010, 2010) (UA-03/2010, 2010) (UA-04/2010, 2010) (UA-01/2015, 2015) (UA-02/2015, 2015), të nxjerra dhe shpërndara nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), që është pjesë e Ministrisë së Administratës Publike (MAP), për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë KRPP-në, por ato nuk i mbulojnë kërkesat e KRPP-së .
- c) Plani i Vazhdimësisë së Biznesit (BCP) dhe Plani i Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë (DRP) nuk ishte zhvilluar dhe zbatuar siç duhet dhe efektiviteti i tyre nuk është testuar.

Rekomandojmë Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

- a) Në organizatë duhet të ekzistojnë politika dhe procedura të cilat do të mundësojnë mbikëqyrje efektive nga ana e menaxhmentit, krijimit të një ambienti pozitiv të kontrollit duke marrë përsipër përgjegjësinë për formulimin, zhvillimin, dokumentimin, shpalljen dhe kontrollimin e politikave që mbulojnë qëllimet dhe direktivat e përgjithshme. Për të arritur objektivat e politikës, procedura duhet të dokumentohet dhe hapat duhet të përcaktohen. Ato do të dokumentojnë proceset e biznesit dhe kontrollet e përfshira. Përveç kësaj, politika dhe procedura duhet aplikuar edhe për palët e treta, të cilët do të duhet të obligohen që ti ndjekin ato.
- b) Procesi i menaxhimit të rrezikut gjithashtu duhet të jetë pjesë e politikave dhe procedurave të miratuara. Kjo duhet të sigurojë që KRPP-ja është në gjendje të:
 - Kuptojë dhe klasifikojë rreziqet që ndikojnë në prokurimin elektronik
 - Marrë vendime mirë të informuara në lidhje me shkallën e rrezikut
 - Përcaktojë shkallën e rrezikut dhe tolerancën e rrezikut për sistemin e e-prokurimit
 - Kuptojë se si të reagohet ndaj rrezikut në mënyrë të kontrolluar.
- c) Duhet të zbatohet Plani i Vazhdimësisë së Biznesit (BCP) dhe Plani i Rimëkëmbjes nga Katastrofat (DRP). Organizata duhet të zhvillojë këto dokumente fillimisht në bazë të një analize të ndikimit të biznesit. Planet dhe rezultatet e testimit duhet të miratohen nga Menaxhmenti i lartë, dhe shqyrtohen për ndryshime në bazë të rregullt (p.sh., rishikimi vjetor, ose pas ndryshimeve të sistemit, të infrastrukturës, apo aplikacionit).
- d) Funkzioni i tavolinës mbështetëse/ndihmëse është përgjegjëse për t'u marrë me mbështetjen e përdoruesve final, menaxhimin e incidentit dhe raportimit, ndërlidhjen me mbështetje teknike për ndryshimin e sistemit dhe korrigjimet dhe funksionet e tjera që sigurojnë funksionimin normal të sistemit.

Praktikat e mira

Për të arritur vlerën e biznesit, biznesi dhe TI duhet të jenë në një linjë. Së dyti, rreziqet e TI-së duhet të menaxhohen, dhe kjo mund të nxitet nga përfshirja e llogaridhënies në ndërmarrje. Ne rekomandojmë zbatimin e Kornizës së përgjithshme të Menaxhimit të shërbimit të TI-së. Rekomandimet siç janë përmendur më lart mund të realizohen me anë të kornizave të njohura ndërkombëtarisht për Qeverisje të TI-së. KRPP-ja mund të konsiderojë shfrytëzimin e njërës nga kornizat që janë të listuara më poshtë, ose në fund të zgjedhin pjesët më të rëndësishmen apo përshtatshme në mesin e tyre.

- COBIT - është zhvilluar nga ISACA për të mbështetur Qeverisjen e TI-së së Ndërmarrjes, duke ofruar kornizën për të siguruar se është në linjë me biznesin, TI mundëson biznesin dhe maksimizon përfitimet, burimet e TI-së shfrytëzohen në mënyrë të përgjegjshme, dhe rreziqet e TI-së menaxhohen në mënyrë të

përshtatshme. Siguron mjete për të vlerësuar dhe për të matur performancën e 37 proceseve të mundshme brenda një organizate (COBIT, 2015).

- ISO/IEC 27001 - Seria e standardeve është grup i praktikave më të mira që ofron udhëzime për organizatat sa i përket zbatimit dhe programit të ruajtjes së sigurisë së informacionit (ISO/IEC 27001, 2011).
- ITIL (Information Technology Infrastructure Library) - është grup i praktikave për menaxhimin e shërbimeve të TI-së (ITSM) që fokusohet në përafrimin e shërbimeve të TI-së me nevojat e biznesit (ITIL, 2011).
- ISO/IEC 20000 - Seria e standardeve është specifikim për Menaxhimin e Shërbimeve të TI-së (ITSM) që është në përputhje me kornizën e menaxhimit të shërbimit të ITIL. Ai përbëhet nga kërkesat specifike për përmirësimin e menaxhimit të shërbimit dhe ofron udhëzime dhe shembuj për zbatimin e saj (ISO/IEC 20000, 2011).

2.2.3 Siguri e pamjaftueshme për Sisteme të Informacionit

Sistemi i e-prokurimit kërkon një mjedis të sigurt për të vepruar me sukses. Masat efektive të sigurisë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kontrollet mbi qasje në të dhëna, përpunim, transmetim dhe ruajtje. Duhet të përcaktohet pronësia dhe përgjegjësia për të arritur rezultatin e dëshiruar.

Kriteret:

- a) Qasja logjike dhe fizike, dhe rrjeti i infrastrukturës, kontrollit, identifikimi dhe qasja do të analizohen dhe vlerësohen për efektivitetin në arritjen e objektivave të sigurisë së informacionit dhe shmangien e humbjeve që rezultojnë nga ekspozimi. Trajtimi i incidentit në aspektin e sigurisë do të vlerësohet për efektivitetin dhe reagim të shpejtë dhe/ose përshkallëzim të problemeve.
- b) Menaxhimi i Sigurimit të Sistemeve të Informacionit duhet të lehtësojë dhe zbatojë një program të sigurisë së informacionit nëpër institucione, e që përfshin analizën e ndikimit të biznesit, planin e vazhdimësisë së biznesit, si dhe planin e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, në mbështetje të proceseve kritike të biznesit të institucioneve.
- c) Sistemi i e-prokurimit do të mbështesë dhe sigurojë strukturat për: nënshkrim digjital/elektronik për ti nënshkruar të gjitha dokumentet, formularët dhe komunikimet; lëshimin e nënshkrimeve digjitale ose metodave tjera alternative në mungesë të nënshkrimit digjital të bazuar në Infrastrukturës se çelësave publike për autentikim (identifikim) dhe enkriptim (sigurimin) e të dhënave të miratuara nga ana e Republikës së Kosovës; dhe për të garantuar transaksionet e siguruara dhe të autorizuara në sistemin e e-prokurimit.

- d) Sistemi do të sigurojë të dhënat e fundit kur transmeton përmes rrjeteve publike dhe WAN. Bartja e të dhënave në mes të serverit të aplikacionit dhe klientit (shfletues të ueb-it) pritet të sigurohen duke përdorur Secure Socket Layer (SSL). Kalimi nga transmetimi në deponim duhet enkriptuar (siguruar) në baza rrjedhëse (streaming) dhe të vazhdueshme.

E gjetura:

- a) Rolet dhe përgjegjësitë ishin të dokumentuara para se të filloj implementimi i sistemit, mirëpo ato nuk identifikojnë plotësisht përgjegjësitë dhe personelin përgjegjës.
- b) KRPP është dashur të sigurojë një mjedis të sigurt për funksionimin e e-Prokurimit në mungesë të Infrastrukturës së çelësave publike. Propozimi për të përdorur sistemin e-ID-së (e-ID, 2014) në pronësi dhe zhvilluar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me nivele të mira të sigurisë kishte implikime logjistike/të kostos dhe KRPP-ja kishte vendosur të lë që përdoruesit të qasen duke përdorur qasje vetëm me një faktor: emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Kjo rrit rrezikun e përdorimit të paautorizuar të sistemit. Çelësat privat janë dërguar në e-mail-at e përdoruesve në formatin XML dhe mbeshin në këtë sistem. E-mailat nuk enkriptohen.

Rekomandojmë Ministrin e Ministrisë të Financave dhe Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

- a) Të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara, të dokumentuara dhe llogaridhënia për grupet dhe individët përgjegjës për sigurinë e informacionit duhet të krijohen dhe të komunikohen me gjithë personelin dhe menaxhmentin përkatës.
- b) Për të siguruar menaxhimin e duhur të sigurisë së informacionit, duhet të kryhen elementet kryesore të mëposhtme:
- Duhet të krijohet korniza e politikave me një deklaratë koncize të Menaxhmentit të lartë për drejtimin, adresimin e vlerës së aseteve të informacionit, nevojën për siguri, dhe rëndësinë e përcaktimit të një hierarkie të klasave të aseteve të ndjeshme dhe kritike. Duhet të përfshijë si në vijim: standardet për të zhvilluar kritere dhe metoda paraprake matëse si bazë të sigurisë, praktika dhe procedura specifike.
 - Ndërgjegjësimi i sigurisë dhe trajnime për gjithë punonjësit e organizatës dhe aty ku përdoruesit e jashtëm përkatës duhet të marrin trajnim të duhur dhe përditësime të rregullta për të nxitur ndërgjegjësimin e sigurisë dhe pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e shkruara të sigurisë, dhe të futet në përdorim qasja dy-faktorëshe për përdoruesit të cilët qasen në sistem.

Praktikat e mira

Objektivat e sigurisë për të përmbushur kërkesat e biznesit të organizatës përfshijnë si në vijim:

- Sigurimi i integritetit të informacionit të ruajtur në sistemet e tyre dhe në tranzit;
- Sigurimi i disponueshmërinë së vazhdueshme të sistemeve të tyre të informacionit dhe të dhënave;
- Sigurimi i përputhjes me ligjet, rregulloret dhe standardet e aplikueshme;
- Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave të ndjeshme gjatë deponimit dhe në tranzit.

Sipas praktikave më të mira dhe standardeve aktuale (p.sh., ISO 27001 dhe COBIT 5), siguria e mjaftueshme e informacionit mund të sigurohet vetëm përmes një qasje gjithë përfshirëse në raport me të gjitha rreziqet përkatëse. Ndër të gjitha masat e sigurisë të aplikueshme për ofrimin e shërbimeve elektronike, procedura e qasjes (vërtetimit) luan një rol themelor në zbutjen e rrezikut të fshehtë të vjedhjes së identitetit. Në mënyrë që ky rrezik të zbutet, mund të zbatohet vërtetimi i fuqishëm. Kjo është një procedurë e vërtetimit që kërkon kombinimin e faktorëve të shumtë të vërtetimit, përfshirë së paku dy (2) nga të mëposhtmet:

- Njohuria – Diçka që përdoruesi e di; p.sh. fjalëkalimi, numri i identifikimit personal (PIN)
- Pronësia – Diçka që përdoruesi ka në pronësi; p.sh. telefon celular, kartë smart, token
- Trashëgimia - Diçka që përdoruesi është; p.sh. gjurmë gishtash, model zëri, iris/retina

Kombinim i të dyjave të mësipërme paraqet autentifikim dy-faktorësh.

2.2.4 Ndërveprimi

Sistemi i e-prokurimit është projektuar për të shkëmbyer informacion me TI-të me rëndësi për të vërtetuar dhe procesuar të dhënat në mënyrë efektive. Të tri institucionet kryesore me të cilat sistemi do të shkëmbejë të dhëna janë:

- a) Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)- për të verifikuar të dhënat e subjekteve, si dhe detyrimet e tyre përkatëse ndaj ATK-së. Duke përdorur numrin fiskal do të duhej të kontrollojë ekzistencën e subjektit, të marrë të dhënat bazë dhe kontrollojë nëse subjekti ka paguar të gjitha taksat.
- b) Thesari - për të verifikuar informatat financiare dhe buxhetore në lidhje me entitetin dhe detyrimet e tyre për autoritetin kontraktues ose ndonjë subjekt tjetër. Ky i fundit do të duhej të kontrollojë se kodi UNIREF është përdorur saktë gjatë pagesës së depozituar për ankesë nga një operator ekonomik, dhe duhet të kontrollojë pagesën për faturat që janë dërguar nga furnizuesi.

- c) Autoriteti kontraktues mund të pranojë faturën dhe menaxhojë pagesat e Thesarit të Kosovës përmes softuerit për menaxhim financiar "Sistemi FreeBalance" përmes kërkesës së duhur për ueb shërbime.
- d) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)- për të verifikuar dhe vërtetuar certifikatat në e-ID karta.

Kriteret:

Ky sistem e-Prokurimi duhet të ndërveprojë me sistemet e jashtme për verifikim dhe me marrje të informacioneve në lidhje me regjistrimin e biznesit, taksave dhe pagesën e TVSH-së, informacion të përditshëm për këmbim valutor, dhe e-Katalogun.

E-prokurimi do të mund të integrohet/ndërveprojë me sistemin "Free Balance", e-ID, regjistrim të biznesit dhe tregtisë, Sistemin e taksave dhe TVSH-së, e-katalog.

E gjetura:

- Administrata Tatimore të Kosovës (ATK) ka aktivizuar shërbimin dhe i ka ofruar zgjidhje KRPP-së. Megjithatë, zgjidhja nuk është implementuar deri në muajin Shkurt 2016, gjatë kohës kur ne ishim në auditim. Zgjidhja do të vepronte si ueb shërbim, ku kërkesat me numrin fiskal të biznesit do të dërgoheshin në ATK, dhe ATK-ja do të përgjigjej duke siguruar informacion në lidhje me pronarin e numrit fiskal. Zgjidhja është testuar jashtë sistemit të e-prokurimit (si zgjidhje më vete), por jo si zgjidhje e inkorporuar në sistemin e e-prokurimit. Kjo mangësi është tejkualuar pas përfundimit të punës tonë në terren. Ne kemi arritur ta testojmë online funksionimin e këtij aplikacioni.
- Shkëmbimi i të dhënave me Thesarin nuk është implementuar e as testuar kurrë. Ka pasur probleme komunikimi ndërmjet Thesarit dhe KRPP-së pasi përkufizimet nuk ishin të përcaktuara qartë, e as mundësitë e implementimit nuk janë diskutuar.
- Edhe pse zgjidhja me MPB është prezantuar gjatë fazës së zbatimit të projektit, KRPP ka vendosur të mos implementojë këtë zgjidhje për arsye të panjohura, edhe pse MPB ka treguar vullnet dhe gatishmëri për të mbështetur implementimin.

Rekomandojmë Ministrin e Ministrisë të Financave dhe Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

KRPP-ja është duke i rishqyrtuar dhe vlerësuar planet për të siguruar ndërveprimin efektiv në ato fusha të përcaktuara me plane fillestare. Gradualisht, bashkimi me sistemin e E-prokurimit duhet të planifikohet për implementim sa më shpejt që është e mundur. Kjo do të promovojë cilësinë dhe sigurinë e planifikuar për aspektet e sistemit dhe shmangien e futjes së të dhënave të rreme (ose të duplikuara).

Ndërlidhja e besuar me sistemin e Thesarit duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, për të verifikuar dhe përpunuar informacionin e kërkuar.

2.2.5 Joefikasitet në transfer të njohurive

Deri në fund të këtij viti, të gjitha certifikatat e përdoruesve të prokurimit do të skadojnë. Sipas ndryshimeve të reja të ligjit për prokurimin publik (Ligji nr. 05/1-068, 2016), të gjithë zyrtarët e prokurimit duhet të kryejnë programe trajnimi dhe të certifikohen në përputhje me rregullat, udhëzimet dhe vendimet përkatëse të KRPP-së deri më 31.12.2016. Një nga modulet e këtij programi trajnues është edhe e-prokurimi. Janë diku rreth 800 përdorues në nivel të qeverisë që duhet të trajnohen për të përdorur e-prokurimin.

Tavolina ndihmëse si pika e parë e kontaktit për ndihmë ndaj përdoruesve, që të identifikojnë dhe gjejnë zgjidhje për çështje të ndryshme të përdorimit të sistemit duhet gjithë ashtu të jenë të trajnuar.

Kriteret:

Ofertuesi, në këtë rast INFODOM-i, do të ofrojë një plan gjithëpërfshirës të trajnimit dhe do të ekzekutojë të gjitha aktivitetet relevante për transferimin e njohurive dhe aftësive teknike për përdoruesit.

- Përdoruesi: Ofertuesi i Sistemit të e-Prokurimit do të sigurojë trajnimin e trajnuesve për përdoruesit nga KRPP, Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe autoritetet kontraktuese;
- Aspekti teknik: Ofertuesi i Sistemit të e-Prokurimit do të ofrojë trajnime teknike në nivel sistemi për ekipin teknik të KRPP-së për probleme (trouble shooting), qendrën e konfigurimit të të dhënave, të dhënat backup dhe rikthimin, dhe probleme të tjera teknike në sistemin e e-prokurimit.
- Menaxhmenti: Ofertuesi i Sistemit të e-Prokurimit do të ofrojë trajnime menaxheriale për sistemin e e-prokurimit një grup të administratorëve të sistemit të e-Prokurimit, dhe administratorët e Autoritetit Kontraktues.
- Manualët: Ofertuesi i Sistemit të e-Prokurimit do të përgatisë dhe ofrojë manuale ndaras për secilin nga llojet e përdoruesve të përmendur.
- Vizita studimore: Ofertuesi i Sistemit të e-Prokurimit do të organizojë një udhëtim studimor për shtatë (7) persona për një javë, (emërimi i pjesëmarrësve do të bëhet nga KRPP-ja në mesin e palëve kryesorë të interesit që janë të kyçur në implementimin e sistemit të e-prokurimit) në një nga vendet evropiane, ku sistemi i ofruar i e-prokurimit funksionon me sukses me shumicën e funksioneve të ngjashme me sistemin e prokurimit që do të zbatohet në Republikën e Kosovës.

Të gjeturat:

Në përfundim të auditimit tonë ne kemi vërejtur se nuk ka pasur trajnim për përdoruesit e E-prokurimit, nuk janë ofruar trajnime për ekipin teknik, trajnime menaxheriale e as nuk janë përgatitur manuale për përdoruesit e sistemit të E-prokurimit, trajnime këto të parapara me kontratë. Ndërsa sa i përket vizitës studimore, nuk na është ofruar ndonjë raport mbi përfitimet e kësaj vizite.

Nuk është mbajtur as trajnimi i prituri i 800 përdoruesve . Është mbajtur një trajnim shumë i kufizuar për Trajnim-të-Trajnerëve (ToT). KRPP-ja është duke planifikuar të trajnojë 300 përdorues këtë vit - normë e trajnimit e cila do të kërkonte tre vjet (3) për të trajnuar të gjithë përdoruesit dhe kështu do të vononte zbatimin e plotë të e-Prokurimit brenda të njëjtave afateve kohore.

Rekomandojmë Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

Të zhvillojë një plan të detajuar dhe me prioritet të trajnimit për grupin e përdoruesve dhe të zbatohet brenda një afati kohor të rënë dakord për të siguruar që përdoruesit janë të trajnuar dhe certifikuar për përdorim efektiv të sistemit.

2.2.6 Sigurimi joadekuat i performancës së sistemit

Për të përcaktuar nëse kërkesat institucionale janë përmbushur dhe janë të vlefshme, është e rëndësishme që të kryhet testimi i duhur i sistemit të implementuar për të siguruar se i plotëson kërkesat e përdoruesit. Përdorimi i Sistemit mund të reduktohet në qoftë se përfitimet e pritura nuk realizohen.

Kriteret:

Blerësi (me ndihmën e ofertuesit) do të kryejë testimet e mëposhtme mbi sistemet dhe nënsistemet për të përcaktuar nëse i përmbushin të gjitha kërkesat e mandatuar për pranim operacional.

- Testimi i Njësive - vërteton se secili modul individual i sistemit të e-prokurimit është duke funksionuar siç duhet;
- Testimi i funksional - vërteton se kërkesat e detyrueshme funksionale të sistemit të ofruar funksionojnë si duhet. Është e nevojshme që sistemi i ofruar të përputhet me specifikimet.
- Testimi i Integritetit - vërteton se pjesët e kombinuara ose modulet e sistemit të e-prokurimit janë duke funksionuar si duhet
- Testimi i vëllimit - vërteton se çdo vlerë që mund të rritet me kalimin e kohës, mund të akomodohet nga programi dhe nuk do të bëjë që sistemi të ndalojë punën ose në ndonjë mënyrë të degradojë operacionin
- Testimi i Performancës - vërteton se sistemi i plotë operon në përputhje me kërkesat e biznesit;

Sistemi i e-Prokurimit do të implementohet në mënyrë graduale. Gjashtë (6) agjenci të nominuara qeveritare do të fillojnë përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik në fazën e implementimit pilot.

Testimet Operacionale të pranimit të përdoruesve do të jenë përgjegjësi kryesore e Blerësit.

Të gjeturat:

Në përfundim të auditimit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje të verifikojmë nëse janë bërë të gjitha testimet nga ana e Blerësit. Ofertuesi i ka dhënë librat e testimit/rastet, por ato janë realizuar vetëm pjesërisht. Komunikimi dhe përgjigjja ndaj kërkesave nga ana e Blerësit janë bërë pjesërisht duke përdorur librat e testimit/rastet, dhe pjesërisht duke marrë Print Screen dhe dërguar ato përmes e-mailit tek Ofertuesi. Si e tillë është pothuajse e pamundur të gjurmohet dhe të verifikohet kompletimi i ndryshimeve.

Është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi (MM) me shtatë (7) institucione: Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Korporatën Energjetike të Kosovës. Këtu specifikohet se këto institucione do të fillojnë të përdorin e-Prokurimin vetëm si metodë “shkollore” ose e “të mësuarit”, por nuk specifikon metodën matëse të performancës, apo rezultatet e pritshme të qasjes së implementimit të kësaj faze. Është gjithashtu e paqartë se cilat do të jenë kriteret bazë të pranimit, në mënyrë që të deklarohet nëse faza pilot ka qenë e suksesshme ose jo. Gjithashtu është e paqartë se si do të testohet sistemi dhe/ose mësohet, nëse nuk shkëmbehen informacione mes ATK-së dhe Thesarit.

Sikurse edhe testimet e mëparshme (testet e njësisë, funksionale, integritit, volumit, dhe të performancës), nuk janë kryer e as dokumentuar plotësisht, rezultatet nga Testimi Operacional i pranimit të përdoruesve mund të shtyjë implementimin e suksesshëm të sistemit, nëse dalin në pah çështjet madhore.

Rekomandojmë Kryetarin e Bordit të KRPP-së të sigurojë që:

Të gjitha pranimet operative të specifikuara në planin e projektit duhet të zbatohen dhe rezultatet të dokumentohen në një periudhë kohore të përcaktuar qartë.

Kriteret e pranimit duhet të përcaktohen për institucionet e pilotuara, me qëllim që të vërtetohet funksionimi i duhur i sistemit.

Testimet e pranimit të përdoruesve duhet të kryhet plotësisht dhe dokumentohet para pranimit të sistemit dhe ngritje në ambient punues.

Terminologjia

Authentication (Autentikimi)	Është një proces në të cilin kredencialet e dhëna krahasohen me ato në dosje në një bazë të dhënash të informacionit të përdoruesve të autorizuar në një sistem operativ lokal apo brenda një serveri verifikimi. Nëse kredencialet përputhen, përdoruesit i mundësohet qasja
Backup (kopje rezerve)	Procedura për krijimin dhe rruajtjen e kopjeve të të dhënave, të cilat do të shfrytëzoheshin në rast të humbjes apo demtimit të të dhënave origjinale
Business Continuity Plan - BCP (Plani i Vazhdimësisë së Biznesit)	Është një plan për të vazhduar operacionet në qoftë se një ambient apo hapësirë e organizatës është prekur nga nivele të ndryshme të fatkeqësisë, të cilat pamundësojnë rrjedhjen normale të operacioneve të saj
Cypher (shifrim)	Është metode për enkriptim apo dekriptim të të dhënave
Dashboard (paneli punues)	Është një nderfaqje e shfrytëzuesit që organizon dhe paraqet informacionet në një mënyrë që është e lehtë për tu lexuar
Digital Signature (Nënshkrimi Digjital)	Është një identifikues elektronik i një personi ose subjekti i krijuar duke përdorur një algoritëm matematikor të destinuar për të verifikuar një marrësi integritetin e të dhënave dhe identitetin e dërguesit
Disaster Recovey Plan - DRP (Plani i Rimëkëmbjes nga Fatkeqesit)	Është një proces i dokumentuar apo pako procedurash për të rimëkëmbur dhe për të mbrojtur një infrastrukturë të IT në rast të një fatkeqësie. një plan i tillë, i dokumentuar zakonisht në formë të shkruar, specifikon procedurat një organizatë ka për të ndjekur në rast të një fatkeqësie.
Encryption - Decryption (Enkriptim - Dekriptim)	është një mënyrë për të rritur sigurinë e një mesazhi apo dosje duke shifruar përmbajtjen në mënyrë që të mund të lexohet vetëm nga dikush që ka çelësin e duhur për deshifrim
end-to-end (fund-ne-fund)	Një term i përdorur në shumë fusha të biznesit duke iu referuar pikave të fillimit dhe të fundit të një metode apo shërbimi. Kjo teori përfshin filozofinë për të eliminuar sa më shumë shtresa të mesme apo hapa që të jetë e mundur për të zgjedhur punën dhe efikasitetin në çdo proces
Interface (nderfaqje)	Është një kufi i përbashkët nëpër të cilën dy komponente të veçanta të një sistemi kompjuterik shkëmbejnë informacione. Shkëmbimi mund të jetë në mes të programeve, pajisjeve kompjuterike, pajisjeve periferike, njerëzve dhe kombinimet e tyre
M-Technologjia	Shkurtesa prej Mobile Technology, e cila mundëson qasjen dhe shfrytëzimin e sistemit nga pajisjet mobile
Patch (arnim)	Një arnim është një pjesë e softuerit e projektuar për të rinovuar një program kompjuterik apo të dhënat e saj mbështetës
Public Key Infrastructure-PKI (Infrastruktura e Çelesave Publike)	është një grup i roleve, politikave dhe procedurave të nevojshme për të krijuar, menaxhimin, shpërndarjen, përdorimin, deponimin, dhe revokimin e certifikatave dixhitale dhe për të menaxhuar shifrimi publik-Çelesave

RACI chart	RACI është shkurtesa per Responsible, Accountable, Consulted and Informed, e cila tregon kush eshte përgjegjës, kompetent,i konsultuar dhe informuar, të cilat janë katër parametrat në një matricë të përdorura në vendimmarrje. RACI tabela përshkruan aktivitetet e ndërmarra në kuadër të një organizate nga personat apo rolet
RPO – Recovery Point Objective (Objektivi i pikës së rimëkëmbjes)	RPO është e përcaktuar me planifikimin e vazhdimësisë së biznesit . Kjo është periudha maksimale e shenjestuar në të cilën të dhënat mund të jenë të humbura nga një shërbim IT për shkak të një incident
RTO – Recovery Time Objective (Objektivi i kohës së rimëkëmbjes)	RTO është kohëzgjatja e shënjestuar e kohës dhe një nivel i shërbimit në të cilin një proces i biznesit duhet të rikthehet pas një fatkeqësie (ose nderprerje), në mënyrë që të shmangen pasojat e papranueshme që lidhen me një nderprerje në vazhdimësinë e biznesit
Secure Socket Layer - SSL	Është standard I teknologjise të sigurisë për vendosjen e një lidhje të koduar në mes të një ueb serveri dhe një shfletuesi. Kjo lidhje siguron që të gjitha të dhënat qe kalojn në mes të ueb serverit dhe shfletuesit të mbeten private dhe integrale
Streaming	Është një teknikë për transferimin e të dhënave në mënyrë që të mund të jenë të përpunuara si një rrjedhë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme
Swim Lane	Shumë metodologji per modelimin e proceseve përdorin konceptin e swimlanes, si një mekanizëm për të organizuar aktivite në kategori të veçanta vizuale në mënyrë për të ilustruar aftësi të ndryshme funksionale apo përgjegjësi (rolet organizative). Është një element vizual i përdorur në skemat e rrjedhës ose flowcharts, që vizualisht bën dallimin dhe ndarjen e punës dhe përgjegjësi për nën-proceset e procesit të biznesit
UNIREF - Unified Reference Payment Code	Instrument I perdorur per identifikimin e klasifikimin e pagesave, si dhe regjistrimin e tyre ne SIMFK
Update (përmiresim)	Është procesi për shtimin e informacionit të ri ose për të bërë korrigjimet shtesë
User Acceptance Test-UAT	Është faza e fundit e procesit të testimit të softuerit. Gjatë UAT, përdoruesit aktuale softuerike testojnë softuerin për të siguruar se mund të trajtojë detyrat e kërkuara në skenarët e botës reale, sipas specifikave. UAT është një nga procedurat e fundit dhe kritike të projektit softuerik që duhet të ndodhin para se softueri i zhvilluar lansohet per shfrytezim
Wide Area Network - WAN	Është një rrjet i telekomunikacionit ose rrjetit kompjuterik që shtrihet mbi një distancë të madhe geografike
XML-Extensible Markup Language	është një gjuhë shenuese që përcakton një sërë rregullash për dokumente te shifruara në një format që është edhe e lexueshme për njerezit por edhe makinat

Referencat

Aberdeen Group. (n.d.). *Best practice to e-procurement*.

COBIT. (2015). Retrieved from ISACA: <http://www.isaca.org/cobit>

DIRECTIVE 2014/24/EU. (2014). *DIRECTIVE 2014/24/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL*. EU. Retrieved from <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0024&from=EN>

e-ID. (2014). *e-ID*. Retrieved from MPB: www.mpb-ks.org/?page=1,244

IGS-PPRC. (2012, October). *e-Procurement Readiness and Roadmap*. PPRC. International Governance Solutions.

Interoperability Framework. (2013, April 4). *Interoperability Framework of the Republic of Kosovo*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Prishtine: Ministria e Administratës Publike. Retrieved from <https://map.rks-gov.net/institucion/Plan-and-Strategies/Korniza-e-Interoperabilitetit-e-Republikes-se-Koso.aspx?lang=en-US>

ISO/IEC 20000. (2011). *ISO/IEC 20000-1:2011 Information technology -- Service management*. Retrieved from ISO-International Standards Organization: http://www.iso.org/iso/catalogue_detail?csnumber=51986

ISO/IEC 27001. (2011). *ISO/IEC 27001 - Information security management*. Retrieved from ISO-International Standards Organization: <http://www.iso.org/iso/home/standards/management-standards/iso27001.htm>

ITIL. (2011). *ITIL - best practices solutions*. Retrieved from Axelos: <https://www.axelos.com/best-practice-solutions/itil>

Komtel, H. (2015). *HelpDesk*. Retrieved from KomtelPe: www.komtelpe.net/HD

Ligji nr. 05/1-068. (2016, January 6). *Ligji nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-237*. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtine: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03. (2014, December 8). Contract for Procurement of Development or customization of transactional modules for e-procurement system, including ICT infrastructure and contract management information system. *RFP No.PSMP/PPRC/1B2.1/2014-02/03*.

Raporti Vjetor i Prokurimit 2014. (2015). *Raporti Vjetor i Prokurimit 2014*. KRPP. Retrieved from KRPP: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2014/Raporti%20vjetor%202014%20Shqip%20KRPP.pdf>

Tatimi ne Prone. (2015). *Fatura e Tatimit ne Prone*. Retrieved from <https://fatura.tatimineprone-rks.org/>

UA-01/2010. (2010). *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2010 -MAP MBI SIGURINË DHE QASJEN NË BAZAT E TË DHËNAVE*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7833>

UA-01/2015. (2015). *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAP) NR. 01/2015 PËR UEB FAQET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

- UA-02/2010. (2010). *UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2010 PËR MENAXHIMIN E SIGURISË INFORMATIVE*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7864>
- UA-02/2015. (2015). *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAP) NR. 02/2015 PËR LLOGARITË ELEKTRONIKE ZYRTARE*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11011>
- UA-03/2010. (2010). *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2010 PËR PËRDORIMIN E SOFTUERIT DHE HARDUERIT*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7965>
- UA-04/2010. (2010). *UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 04/2010 PËR SHFRYTËZIMIN E POSTËS ELEKTRONIKE ZYRTARE NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS*. Ministria e Administratës Publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7966>
- World Bank PSMP. (n.d.). *Public Sector Modernisation Project*. Retrieved from Project Status:
<http://www.worldbank.org/projects/P101614/public-sector-modernization?lang=en&tab=details>